REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 386/13 Data: 15.01.2013
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 386/13
Datë 15.01.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 15.12.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

Për akreditimin e Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë "APPK", Prishtinë, për periudhën: 15/12/2012 - 31/07/2015 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1. Teknologji Informative dhe e komunikimit TIK (niveli i KKK-së-II)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Hapësira e pritjes (përballë recepsionit) nuk është e mjaftueshme për fluksin e kandidateve që vizitojnë dhe vijojnë trajnimet/edukimin në objektin e APPK-së, përfshi edhe trajnimet dhe certifikimet e ECDL-it. Rekomandohet që këto hapësira të rriten duke u bazuar në numrin e kandidatëve.
- Në derën e sallës së kompjuterëve (trajnimeve për teknologji informative) nuk ka shënim se për çfarë përdorët salla. Rekomandohet që të vendoset informacioni për këtë sallë dhe për sallat e tjera.
- Salla e kompjuterëve është e pajisur me 20 kompjuter për nevoja të kandidatëve, një kompjuter për nevoja të trajnerit/instruktorit, një projektor, një panel për projektim dhe një tabelë pune. Në bazë të kësaj duket e ngushtë për të akomoduar të gjitha këto;

shto këtu edhe numrin e pjesëmarrësve prej 20 vetave. Konform etikës profesionale të hapësirave të trajnimit, tepihu në dysheme dhe kabllot e rrjetit të shtrira nëpër tokë, së bashku me vështirësitë që në rreshtin e majtë, respektivisht të djathtë hasin kandidatet gjatë uljes në kompjuterët respektiv janë tregues se ka nevojë për përmirësim të kësaj hapësire.

- Kopjet rezervë (backup) të të dhënave të organizatës e cila është rreth 100GB, përveç që ruhen në lokalet e organizatës, një kopje ruhet edhe në ambiente private tek shtëpia e zyrtarit të teknologjisë informative. Rekomandohet që kopjet rezervë të mos ruhen në ambient privat por të hulumtohen dhe të gjenden mundësi për ruajtjen në ambiente online ose edhe në ambiente tjera të kontraktuara
- Nga informatat në ditën e vizitës u informuam që kompjuterët që përdoren për nevoja të trajnimit sistemin operativ (Windows XP) nuk e kanë të licencuar. Gjithashtu, edhe programi aplikativ MS Office 2003 nuk është i licencuar. Rekomandohet që kopjet pirate të zëvendësohen me kopje origjinale në afatet sa më të shpejta të mundshme.
- Ambienti i ndarë për dhomën e serverit është në një pjesë të korridorit tepër e ngushtë dhe gjatë sezonit të verës nuk është e sigurt si pasojë e temperaturave të larta që mund të mbretërojnë në atë ambient. Po ashtu kabllimi i cili shtrihet nga aty deri tek kompjuterët e tjerë nuk është i strukturuar me çka nuk dihet se cilat kabllo për çfarë janë. Rekomandohet që të gjenden një ambient më i mirë për dhomën e serverit sipas standardeve të përcaktuara për "server room". Po ashtu rekomandohet që kabllot të identifikohen dhe të jetë një skemë e cila përshkruan secilën kabllo.
- Nga këndvështrimi i kandidatëve, u potencua se është distanca e vogël në mes të projektorit dhe panelit për projektim, orët e pa mjaftueshme për disa nga modulet e trajnimeve, dhe pagesa e papërballueshme për riprovim në vlerë prej 15.00€ (duke qenë se kandidatet janë të papunë – kërkues pune) janë disa nga konsideratat që duhet shqyrtuar.
- Programi i zbatuar për trajnimin e ECDL ka si përmbajtje sistemin operativ Windows XP dhe Microsoft Office 2003. Rekomandohet që të bëhet përditësim i programit, në mënyrë që kandidatëve të mund të ju ofrohet trajnimi për versionet e fundit të sistemit operativ dhe paketës së Office-it.
- APPK që nga themelimi e deri në ditët e sotme posedon numër të madh të kandidatëve që kanë vijuar dhe janë certifikuar në modulet e trajnimeve nga me të ndryshmet, përfshi edhe të TI-së. Kjo rrjedhimisht hap diskutimin në lidhje me bazën e strukturuar të të dhënave në të cilën duhet ruajtur të dhënat e gjithë atyre kandidatëve nga e kaluara e deri me tani. Kështu, aktualisht APPK nuk posedon një bazë të dhënash të organizuar mirë, të mbrojtur dhe të centralizuar, gjë që vë në diskutim ruajtjen e intimitetit/identitetit te të dhënave të kandidatit!
- Edhe përkundër faktit që kandidatit i ofrohet edukimi profesional në fushën e teknologjisë informative ashtu që ai/ajo të shtojë mundësitë e gjetjes se punës dhe fakti që në masë të caktuar APPK bashkëpunon me sektorin privat për të ndihmuar sado pak kandidatin që të punësohet, serish sikur zinxhiri i komunikimit shkëputet në momentin që kandidati ka gjet punën. Rekomandimi që të shtohet ky komunikim me qellim të marrjes së informatës kthyese dhe të vazhdohet me kontakt me kandidatin deri në akomodimin e plotë të tij/saj.
- Aparateve kundër shuarjes së zjarrit u ka skaduar afati i kontrollit. Rekomandohet që kontrolli të bëhet i rregullt.

- Pjerrina në hyrje të ndërtesës mungon. Rekomandohet që të ndërtohet pjerrina në mënyrë që të ju mundësohet qasja edhe personave me aftësi të kufizuara (personave me karroca).
- Shenjat e daljeve emergjente janë të vendosura edhe tek dritaret e kateve të larta. Rekomandohet që këto shenja të largohen nga këto pjesë.
- Meqenëse objekti është nën vëzhgimin e kamerave, rekomandohet që të vendosen shenjat informuese që jeni nën vëzhgimin e kamerave konform ligjit.
- Meqë APPK është një vatër e mirëfilltë e diturisë profesionale, me këtë edhe ambienti punues i organizatës në fjalë në baza ditore është i stërmbushur, pjesëmarrësit e trajnimit të TI-se nuk dallohen nga nëpunësit e organizatës. Kjo vë në pah faktin që medoemos duhet të vendoset një standard ne identifikimin e nëpunësve nga pjesëmarrësit.

Afati përmbushjes se këtyre kushteve është: 01.07.2013

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë:15.12.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

- "APPK" Prishtinë;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi